



## KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

### VENDIM

**NR. 7/4 , DATË 04/03/ 2019**

### **PËR SHTYRJEN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK “ALBPANEL”**

Në mbështetje të Nenit 9, 18 dhe 21 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Pikës 1 të Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 7/1 Prot, datë 05.12.2016 “Për miratimin e statusit strategjik ‘investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar’ për projektin e investimit strategjik Albpanel vlerësoi:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me vendim Nr. 7/1 Prot, datë 05.12.2016 “Për miratimin e statusit strategjik ‘investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar’ ka vendosur miratimin e statusit strategjik për projektin “Albpanel” me subjekt Albpanel NUIS/NIPT: L61605017K për realizimin e një impianti prodhimi të paneleve MDE duke përdorur si lëndë të parë kallamin dhe mbetje të çdo lloji tjetër produkti agro - bujqësor me përbërje fibroze, me kusht nënshkrimin e Marrëveshjes së Garancive Financiare.
- Marrëveshja e Garancive Financiare dhe Kontrata e Përdorimit të Tokës janë lidhur ndërmjet subjektit “Albpanel” dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë më datë 05.10.2018.
- Duke qenë se lloji i projektit të synuar nuk ka ndryshuar dhe vlera e investimit me numrin e punësimit plotësojnë kriteret e parashikuar nga legjislacioni,

## KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

### VENDOSI:

1. Shtyrjen e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit strategjik “Albpanel”, për një periudhë 2 (dy) vjeçare.
2. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Albpanel” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për

miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

3. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike.
4. Ngarkohet Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Bashkia Fier, Bashkia Divjakë, Zyra Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
ERION BRAÇE

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
ANILA DENAJ

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
BLEDI ÇUÇI

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
BLENDI KLOSI

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
ARTUR METANI

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS  
SOKOL NANO